

KARTELE INFORMATIVE				
				AL052040
1. Emri i shërbimit	Regjistrimi dhe Akreditimi i Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Sipas detyrimit ligjor të ligjit me nr.9880 (për nënshkrimin elektronik) datë 25.2.2008 ndryshuar me ligjin 122/2016			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Subjekti akreditohet si ofrues i kualifikuar i shërbimeve të besuara, për lëshimin e certifikatave elektronike dhe vulës elektronike në Republikën e Shqipërisë.			
4. A jam përfitues?	Biznes / Person Juridik (Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara, Shoqëri Anonime)			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Kërkesë për akreditim	Subjekti	Po
	2	Mandat pagesë	Banka	Po
	3	Dokument lëshuar nga Gjykata që vërteton se, personi nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë nga veprat e parashikuara në rregulloren "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", pjesa III, Kushtet ligjore, teknike, profesionale dhe financiare, pika 4, Besueshmëria ligjore;	Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Po
	4	Dokument që vërteton se, subjekti nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij nuk janë në duar të përmbarrimit dhe në proces konfiskimi (Ekstrakti historik);	Qendra Kombëtare e Biznesit/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Po
	5	Dokument të lëshuar nga Administrata Tatimore, që vërteton se subjekti: a) ka plotësuar detyrimet fiskale; b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore.	Drejtoria Përgjithshme Tatimeve	Po
	6	Depozitë ose garanci të lëshuar nga një bankë ose policë sigurimi pa kusht, të lëshuar nga një shoqëri e licencuar në fushën e sigurimeve dhe që mbulon edhe këtë kategori shërbimi. Garancitë financiare duhet të jenë të vlefshme përgjatë gjithë kohës së aktivitetit të ofruesit të shërbimit dhe në përputhje me pikën 7 të rregullores "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara", miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 69 datë 27.1.2016.	Banka	Po
	7	Politika e Certifikatave/ Certificate Policy, dokument i cili përfshin të gjitha rregullat dhe praktikat për besueshmërinë e veprimtarisë së lëshimit të certifikatave të kualifikuara, për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik, vulave elektronike, sistemin e transmetimit elektronik dhe certifikatat për autentifikimin e faqeve të internetit.	Subjekti	Po

	8	Deklarata e Praktikave të Certifikatave/Certificate Practice Statement, dokument i cili përshkruan praktikat dhe procedurat e përdorura për të adresuar të gjithë kërkesat e identifikuar në Politikën e Certifikatave.	Subjekti	Po
	9	Dokumenti i politikave të sigurisë së informacionit/Security Police, dokument i cili përcakton përjasjen e ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar për menaxhimin e sigurisë së informacionit të tij.	Subjekti	Po
	10	Certifikatat e prodhuesit, të pajisjeve apo sistemeve kriptografike, që do të përdoren për ofrimin e shërbimeve të besuara.	Prodhuesit e sistemeve	Po
	11	Format kontrata mbi temat dhe kushtet e përdorimit të certifikatave të kualifikuara, e cila lidhet ndërmjet Ofruesve Kombëtare të Shërbimit të Besuar (OKSHB) dhe zotëruesve të certifikatave.	Subjekti	Po
	12	Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS)	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	Jo
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)	Tiranë	Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Nr 1, Tiranë	E hënë - e enjte 08.00 - 16.30; E premte 08.00 -14.00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
	☒	☐	☐	☐
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	20 000 Lek	Komisioni i Bankës	Nuk ka	Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	Brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të dokumentacionit shtesë			
10. Çfarë përfitoj?	Akreditohet si ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Pa afat (Në momentin e auditimit nga AKCESK rezulton që subjekti nuk i ka plotësuar kushtet teknike, ligjore dhe financiare, qëndron e drejta e humbjes së statusit të kualifikuar)			
12. Ku e marr?	Në sportele ☒	Me postë ☒	E-albania ☐	Me e-mail ☐
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontaktto në: E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al AKCESK web: www.akce.gov.al/ Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Orari Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele ☒	Me postë ☐	Web-i i Institucionit ☐	Me e-mail ☐
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		☒	☐

16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?

Ligj nr 107/2015 "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara (Ndryshuar me ligjin Nr 123/2016)"
Ligji me nr 9880 "Për nënshkrimin elektronik" datë 25.02.2008 ndryshuar me ligjin 122 /2016
VKM Nr 69, datë 27.01.2016 "Për miratimin e rregullores për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara"
VKM me nr 495 "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike datë 18.09.2013"
VKM Nr 503 datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për shërbimet që ofrohen nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik i ndryshuar me VKM Nr 71 Date 27.01.2016"
Udhëzim nr. 1: Për dokumentacion e regjistrimit të ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar
Udhëzim nr. 2: Për dokumentacionin e regjistrimit të organizmit të testimit dhe konfirmimit
Udhëzim nr. 3: Për afatet e përgjithshme
Udhëzim nr 4: Mbi procedurat e identifikimit dhe vulave elektronike (i përditësuar)